



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1031/2 Prot.

Tiranë, më 17/04/2025

V E N D I M

Nr. 18, datë 17.04.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E SHPËRNDARJES TË KUOTAVE TË MIRATUARA PËR PROGRAMIN
E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI
FIZIKE” SIPAS PROFILEVE DHE KATEGORIVE, NË FAKULTETIN E
INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE, NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit Nr. 04, datë 21.01.2025 “Një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin Nr. 06, datë 19.02.2018 ‘Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit’”, i ndryshuar, VKM 41, datë 24.01.2018, pika 2.7, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies, neni 18, pika 2, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, mbështetur në propozimin e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, dhe në Relacionin e ardhur nga Drejtoria e Kurrikulave, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.04.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpërndarjes të kuotave të miratuara për programin e ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike” ndërmjet dy profileve të tij, profili Inxhinier Fizike dhe profili Fizikan Mjekësor dhe kategorive, pa tejkaluar kapacitetin maksimal pritës për këtë program studimi të miratuar dhe deklaruar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, për vitin akademik 2024-2025.
2. Rishpërndarja e kuotave të bëhet sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

Kuotat e pranimit, për vitin akademik 2024-2025: FIMIF

Rishpërndarja e kuotave sipas profileve dhe kategorive për programin e studimit “MSc në Inxhinieri Fizike”

Nr	Fakulteti	Programi i studimit	KAPACITETET PRITËSE	SHUMA E KUOTAVE	Kuotat sipas programit të studimit për kandidatët:												
					Shqiptarë brenda vendit	Trojet						Të huaj	Persona me aftësi të kufizuar	Me statusin e jetimit	Romë + balkano egjiptian	Që aplikojnë për Transferim studimesh	Që aplikojnë për program II
						Kosovë	Maqedoni	Mal i Zi	Preshevë	Bujanovc	Medvegjë						
1	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike: Profili Fizikan Mjekësor	16	16	10	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	4
2		Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike: Profili Inxhinier Fizike	14	14	10	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	2
3		Shuma	30	30	20	1	1	0	0	0	0	0	1	0	1	0	6



[Handwritten signature]